



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më .04.2026

MBLEDHJA Nr. 16,
Datë 02 .04.2026, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte , datë 02.04.2026, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr.16, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Miratimin e procesverbaleve të Mbledhjeve të Bordit: Nr.11 dt.02.03.2026, Nr.12 dt.10.03.2026, Nr.13, dt.12.03.2026 dhe Nr.14, dt.19.03.2026 dhe Nr.15, dt.27.03.2026.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “DION Energji” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “ELENERGJI” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROSOL” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 18.09.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “HPG ENERGY” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “EZ-5 ENERGY” sh.p.k për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet barrësimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sha.

7. Mbi kërkesën e shoqërisë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k për marrjen e autorizimit të ERE-s për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
8. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “FUTURE ENERGY TRADING AND EXCHANGE DYNAMICS” sh.p.k., për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës.
9. Çështje të tjera .

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI